

Tërnavë uron besimtarët për Ramazan dhe bën thirrje për ndaljen e luftërave | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

NËNKRYETARJA E PDK-SË, VLORA ÇITAKU, KA KRITIKUAR GJYKATËN SPECIALE PAS BASTISJEVE TË FUNDIT | FAQE 4-5

## ÇITAKU: SPECIALJA KA PËRFUNDUAR NË NJË MEKANIZËM PËRNDJËKËS



Nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka reaguar pas aksioneve të Gjykatës Speciale ndaj Sami Lushtakut, Sylejman Selimit dhe Hajredin Kuçit. Ajo ka thënë se një gjykatë e cila kishte për

detyrë të bënte drejtësi pas akuzave monstruoze e të fabrikuara për trafikim organesh, ka përfunduar në një mekanizëm përndjekës, duke konfiskuar telefona, duke

bastisur shtëpi e duke u përpjekur të instalojë frikë e terror. "Keni me dështu. Nuk ju frikësohet askush. Sepse nuk kemi pse. Dielli do të lindë përsëri", ka deklaruar Çitaku

## ANALISTËT NDËRKOMBËTARË: KOSOVA NUK KA RRUGË TË SHKURTËR PËR ANËTARËSIM NË BE | F. 5



## MYSLIMANËT NË MBARË BOTËN NISIN MUAJIN E RAMAZANIT | F. 5

## AKTUALE



## SHTATË KANDIDATË NË GARËN PËR PRESIDENT TË MAQEDONISË SË VERIUT | F. 2

## SHKURTOHET KOHËZGJATJA E PROCESIT PËR AZIL NË GJERMANI | F. 2

## MBI 300 RASTE TË REJA ME KANCER BRENDA DY MUAJVE NË KOSOVË | F. 6

## EKONOMI



## "PËR FUNDJAVË NË EVROPË", BIZNESËT ANKOHEN SE U KA RËNË PUNA | F. 7

## NGRITJA E ÇMIMEVE NË KOSOVË, ANKOHEN QYTETARËT: NUK IA DILET ME 200 EURO | F. 6

## SPORT



## YLLI FITON DERBIN NDAJ PRISHTINËS, BASHKIMI NUK GABON NDAJ ISTOGUT | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Myslimanët në mbarë botën nisin Muajin e Ramazanit

PRISHTINË, 10 MARS - Miliona myslimanë në mbarë botën po bëhen gati për ta nisur agjërimin në Muajin e Ramazanit që nis më 11 mars, varësisht nga vëzhgimet pamore të Hënës së re. Palestinezët në Rripin e Gazës këtë vit këtë muaj të shenjtë të

islamit e presin mes luftës që po vazhdon midis Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja. Në vende të tjera të botës, myslimanët janë furnizuar me hurma dhe gjësende të tjera ushqimore,

por edhe me fenerë, që për shumë vende myslimane është një dekor që vendoset në rrugë dhe shtëpi gjatë Ramazanit, muajit kur besimtarët agjërojnë nga agimi deri në perëndim të diellit si shenjë sakrifice dhe përkushtimi ndaj Zotit.



## Shtatë kandidatë në garën për president të Maqedonisë së Veriut

SHKUP, 10 MARS - Shtatë kandidatë do të garojnë në zgjedhjet presidenciale në Maqedoninë e Veriut që do të mbahen më 24 prill. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) ka bërë me dije se deri të premtën në mesnatë, shtatë nga njëmbëdhjetë kandidatët e paraqitur kanë arritur të mbledhin nga 10 000 nënshkrime, sa janë të nevojshme për të marrë pjesë në garën presidenciale. VMRO DPMNE-ja opozitare në zgjedhje do të garojë me Gordana Siljanovska-Davkovën, e cila ka mbledhur 28.000 nënshkrime. Lidhja Social Demokrate në pushtet do të garojë me presidentin aktual Stevo Pendarovski, i cili në KSHZ ka dorëzuar rreth 22 000 nënshkrime.

Në garën zgjedhore, Bashkimi Demokratik për Integrim do të garojë me ministrin e Punëve të Jashtme, Bujar Osmani, i cili ka grumbulluar rreth 11 000 nënshkrime, ndërsa opozita e bashkuar shqiptare me Arben Taravarin, kryetarin aktual të Gostivarit, i cili grumbulloi më shumë se 10 000 nënshkrime. Pjesë e garës zgjedhore do të jetë edhe Maksim Dimitrievski, kryetari i komunës së Kumanovës, Stevçe Jakimovski, kryetari i komunës së Karposhit në Shkup dhe Biljana Vankovska, kandidate e partisë "E Majta". Renditja e kandidatëve për në listën votuese do të bëhet e ditur pas shortit që do të hidhet më 28 mars.



Raundi i parë i zgjedhjeve presidenciale do të mbahet më 24 prill, ndërsa i dyti, së bashku me zgjedhjet parlamentare, më 8 maj. Këto zgjedhje vlerësohen shumë të rëndësishme për të ardhmen

evropiane të vendit, ndërsa shërbejnë edhe si test për zgjedhjet parlamentare që do të mbahen së bashku me raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale. Sipas hulumtimeve të opinionit

publik, në epërsi të theksuar është VMRO DPMNE-ja opozitare ndaj LSDM-së, si për zgjedhjet presidenciale, ashtu edhe për ato parlamentare. Bazuar në Kushtetutën aktuale, në raundin e parë është thuar se pamundur që të zgjidhet presidenti, pasi kandidati duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të të regjistruarve në listën zgjedhore apo gjysmën e votave të 1.8 milion zgjedhësve. Në raundin e dytë kalojnë dy kandidatët me më shumë vota, ndërsa fitues zgjidhet kandidati që fiton më shumë vota, me kusht që në zgjedhje të dalë mbi 40 për qind e elektoratit. Fushata elektorale, e cila do të zgjasë 20 ditë, do të nisë më 4 prill.

## Kievi thotë se ka rrëzuar 35 dronë rusë



KIEV, 10 MARS - Kievi tha më 10 mars se ka rrëzuar 35 dronë të lëshuar nga Rusia në mbarë Ukrainën, përfshirë edhe në rajonin e kryeqytetit, duke shtuar se një sulm në një qytet në lindje la të plagosur të paktën nëntë persona. Ukraina tha se sulmet me dronë u lëshuan drejt rajoneve qendrore dhe jugore, ndërkaq në rajonet lindore të Harkivit dhe Donjeckut ka pasur sulme me raketa. "Si rezultat i operacioneve luftuese, 35 dronë Shahed të prodhimit iranian janë

rrëzuar" në mbi dhjetë rajone, thanë Forcat Ajrore përmes një postimi në rrjetet sociale. Në njoftim u tha se dronët u rrëzuan në rajonet qendrore të Kievit, Vinitjas, Çerkasit dhe Dnipropetrovskit, si dhe në rajonet jugore të Odesës, Hersonit dhe Mikolajivit. Më në perëndim, rajonet e Zhitomirit dhe Hmelnitshit, po ashtu, u goditën nga sulme me dronë. Në rajonin e Donjeckut, zyrtarët thanë se një sulm me raketa ruse goditi qytezën e

Mirnogradit. "Granatime ruse në Mirnograd me tri raketa S-300. Të paktën nëntë persona janë plagosur, përfshirë një adoleshent", shkroi në rrjetet sociale kreu i rajonit të Donjeckut, Vadym Filashkin. Në rajonin verilindor të Harkivit, guvernatori Oleg Synegovov tha se është sulmuar një kamp i rekreacionit në qytetin e Bogoduhivit, që është qyteti më i afërt me kufirin rus. Pushtimi rus i Ukrainës tashmë ka hyrë në vitin e tretë.

## Shkurtohet kohëzgjatja e procesit për azil në Gjermani

Berlin, 10 mars - Kohëzgjatja e procedurave të azilit në Gjermani vitin e kaluar u shkurtoi pavarësisht se u rrit numri i aplikimeve. Aplikimi zyrtar zgjati mesatarisht 6.8 muaj më 2023, krahasuar me 7.6 muaj në vitin paraprak, sipas të dhënave të qeverisë të prezantuara gjatë pyetjeve parlamentare. Qeveria gjermane tha se kohëzgjatja e procedurave gjyqësore për apelimet kundër vendimeve për azil, po ashtu, ka rënë me rreth pesë muaj në vitin 2023. Megjithatë, duke zgjatur mesatarisht prej 20.7 muajsh, krahasuar me 26

muaj në vitin 2022, i gjithë procesi i azilit është ende i gjatë dhe dallon shumë në vende të ndryshme të shtetit. Në shtetin perëndimor të Rhineland-Palatinat zgjat rreth pesë muaj, ndërkaq në shtetet sikurse Hese dhe Saksoninë e Ulët kohëzgjatja mesatare e procesit të azilit zgjat në një mesatare prej më shumë se dy vjetësh. Ndërkaq në Brandenburg është kohëzgjatja më e madhe, ku azilkërkuetit kryesisht presin mbi tre vjet. Duke folur për rrjetin RND, Calra Bunker, anëtare e partisë së krahut të majtë, Die Linke,

subjekt që kërkoi nga qeveria këto të dhëna, bëri thirrje për "kuadër më të mirë të punonjësve dhe operim më efektiv të gjykatave administrative, në veçanti në reduktimin e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore". Procedurat e gjata për azil janë rënduese për refugjatët sepse ato ua parandalojnë atyre integrimin dhe krijojnë ndjenjën e pasigurisë, tha Bunker. "Është e papranueshme që azilkërkuetit duhet të presin një mesatare prej një viti e gjysmë derisa statusi i tyre të bëhet i qartë", tha ajo.



## Kurti, Çeku dhe Tërnavë vizitojnë dy xhamitë e restauruara në Prishtinë

PRISHTINË, 10 MARS - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naimef. Tërnavë, i shoqëruar nga kryeministri i vendit, Albin Kurti dhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, kanë vizituar të dielën dy xhamitë e restauruara në Prishtinë, xhaminë "Pirinaz" dhe xhaminë "Alaudin".

Kurti falënderoi Naim Tërnavën për mikpritjen dhe shoqërimin për ta parë renovimin dhe punimet që, sipas tij, janë bërë me një profesionalizëm të jashtëzakonshëm. "Është vlerë e lartë historike dhe kulturore meqenëse mësuam se këtu medresenë e ka përfunduar hoxhë Kadri

Prishtina", ka thënë Kurti pas vizitës që i bëri xhamisë "Pirinaz". Sipas tij, kjo xhami paraqet një rrëfim të rëndësishëm për historinë e kryeqytetit dhe të popullit. Po ashtu, Naim Tërnavë falënderoi Kurtin që në natën e madhe e vizitoi xhaminë "Pirinaz" dhe "Alaudin".



## Tërnavë uron besimtarët për Ramazan dhe bën thirrje për ndaljen e luftërave



Myftiu i Kosovës, Naim Tërnavë, ka uruar besimtarët myslimanë në prag të nisjes së Muajit të Ramazanit, duke uruar që agjërimi i tyre të pranohet dhe duke u lutur për ndaljen e konflikteve në mbarë botën. Tërnavë tha se ky është muaj i mirësisë e faljes, ku shtohet dashuria për fenë dhe Zotin. Ai tha se agjërimi njëmuajor është një adhurim specifik që bëhet vetëm për Zotin. Në mesazhin për Ramazan, kreu i Bashkësisë Islame të Kosovës bëri thirrje për ndaljen e konflikteve në botë, duke mos përmendur ndonjë konflikt specifik

**EPOKA  
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 MARS - Myftiu i Kosovës, Naim Tërnavë, ka uruar besimtarët myslimanë në prag të nisjes së Muajit të Ramazanit, duke uruar që agjërimi i tyre të pranohet dhe duke u lutur për ndaljen e konflikteve në mbarë botën.

Muaji i Ramazanit nis më 11 mars, por data e nisjes ndryshon në shtete të ndryshme, varësisht nga vëzhgimet pamore të Hënës së re. "Nesër fillon muaji i bekuar Ramazan, muaji i agjërit, i mirësisë dhe i faljes. Çdo vit të

gjithë ne e presim këtë muaj me padurim, ngase Zoti na ka nderuar me të. Është muaj në të cilin me të madhe përçohen mesazhe urimi e përgëzimi, është muaj i lutjeve dhe adhurimeve, ku shtohen dashuria për fenë dhe Zotin, muaj me mirësi dhe begati më të shumta seç dikush mund t'i numërojë. Është muaj në të cilin besimtari i sinqertë, përmes agjërit, synon përsosjen e tij morale dhe etike, synon ngritjen e nivelit të solidaritetit material në pikat më të larta, muaj që me veprat dhe përkushtimin e lartë, synon lehtësimin e rrugës së

besimtarit për në Xhenet", ka thënë Tërnavë.

Ai ka shtuar se në çdo Ramazan mbushemi me më shumë shpresë e dhembshuri, ngase ky është një muaj i bujarisë dhe mirësisë, një muaj madhështor në të cilin përkushtimi dhe devotshmëria shtohen dhe besimtarët ndiejnë gëzim edhe më të madh në zemrat dhe shpirtrat e tyre, muaj i cili edhe më shumë na bashkon dhe na e forcon unitetin ndërmjet nesh. "Është muaj i agjërit që konsiderohet një nga pesë shtyllat e islamit, pasi besimtarët abstenojnë nga ushqimi dhe pija dhe qëndrojnë larg nga gjërat e ndaluara nga agimi deri në perëndim. Agjërimi është një adhurim specifik që bëhet vetëm për Zotin xh.sh., është një nga veprimet më të mëdha të afërsisë, është praktikë e të drejtëve dhe simbol i të devotshmëve, pastron shpirtin dhe përsos karakterin, është shkolla e devotshmërisë dhe vendbanimi i udhëzimit. Kushdo që hyn në këtë muaj me qëllim të sinqertë dhe duke e ndjekur rrugën e drejtë, do të dalë prej tij me një dëshmi të drejtë dhe do të jetë me të shpërblyerit në këtë dhe në botën tjetër", ka thënë Tërnavë në mesazhin e tij.

Ai i ka ftuar besimtarët myslimanë kudo që janë, që këtij muaji të bekuar t'i përkushtohen me bindje, adhurim, sinqeritet dhe solidaritet, duke i ruajtur e kultivuar lidhjet familjare dhe duke e shtrirë dorën e ndihmës ndaj të varfërve dhe skamnorëve, duke thirrur në forcim të unitetit dhe vëllazërisë dhe duke refuzuar të gjitha format e ndasisë dhe përçarjes ndërmjet vete. "Lutemi që i Plotfuqishmi ta pranojë agjërimin dhe lutjet tona, t'i japë kombit, shtetit e fesë sonë, siguri dhe stabilitet! Lutemi që konfliktet, luftërat dhe gjakderdhja ndërmjet njerëzve pa dallim race, ngjyre, feje apo kombi, të marrin fund!", ka deklaruar Tërnavë.

## Numër i lartë udhëtarësh nga Kosova që kalojnë fundjavën në Shqipëri

PRISHTINË, 10 MARS - Shqiptarët e Kosovës vazhdojnë ta kenë Shqipërinë zgjedhje të parë për fundjava apo pushime. Edhe këtë fundjavë ishte mjaft i lartë numri i atyre që

hynë në Shqipëri. Udhëtarët shprehen se drejt qyteteve të Shqipërisë shkojnë çdo herë gjatë pushimeve të tyre jashtë angazhimeve të përditshme,

kryesisht për të drekuar apo takuar të afërm. Vetëm përmes pikës kufitare të Morinit, në 24 orë kanë hyrë 9 100 udhëtarë dhe 3 500 automjete.

Gjatë fundjavave, duke ditur

se numri i automjeteve është më i lartë, janë vënë në punë të gjitha sportelet për lehtësim të radhëve gjatë verifikimeve të automjeteve./rtsh





NËNKRYETARJA E PARTISË DEMOKRATIKE TË KOSOVËS (PDK-SË), VLORA ÇITAKU, KA KRITIKUAR GJYKATËN SPECIALE PAS BASTISJEVE TË FUNDIT

## Çitaku: Specialja ka përfunduar në një mekanizëm përndjekës

Nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka reaguar pas aksioneve të Gjykatës Speciales ndaj Sami Lushtakut, Sylejman Selimit dhe Hajredin Kuçit. Ajo ka thënë se një gjykatë e cila kishte për detyrë të bënte drejtësi pas akuzave monstruoze e të fabrikuara për trafikim organesh, ka përfunduar në një mekanizëm përndjekës, duke konfiskuar telefona, duke bastisur shtëpi e duke u përpjekur të instalojë frikë dhe terror. “Keni me dështu. Nuk ju frikësohet askush. Sepse nuk kemi pse. Dielli do të lindë përsëri”, ka deklaruar Çitaku

**EPOKA  
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 MARS - Nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka reaguar pas bastisjeve që po vazhdon Gjykata Speciale në raport me figurat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, tash së

fundi për paraqitjen në EULEX të Sami Lushtakut dhe bastisjen në shtëpinë e Sylejman Selimit. Çitaku ka shkruar të dielën në “Facebook” se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi, Rexhep Selimi, tash e gati katër vjet po mbahen peng në një proces absurd në Hagë. “Një

gjykatë e cila kishte për detyrë të bënte drejtësi pas akuzave monstruoze e të fabrikuara për trafikim organesh, ka përfunduar në një mekanizëm përndjekës, duke konfiskuar telefona, duke bastisur shtëpi e duke u përpjekur të instalojë frikë dhe terror”, ka theksuar ajo. Sipas Çitakut, mungesa e provave në proces po mundohet të kompensohet me krijim të dramave këtu brenda Kosovës. “Të tilla ishin edhe skenarët e ditëve të fundit me Hajredin Kuçin, Sami Lushtakun dhe Sylejman Selimin. Keni me dështu. Nuk ju frikësohet askush. Sepse nuk kemi pse. Dielli do të lindë përsëri”, ka shkruar Çitaku.

Ish-komandanti i UÇK-së, Sami

Lushtaku, i cili këto ditë u thirr në zyrat e EULEX-it, ka thënë se gjatë gjithë jetës së tij është munduar të punojë me nder, duke pasur në mend të parë interesin e vendit dhe popullit. “Jam krenar për gjithçka çfarë kam bërë për vendin tim, liria e të cilit erdhi pas luftës dhe sakrificës së mijëra dëshmorëve e martirëve të cilët ranë gjatë luftës sonë çlirimtare të vitit 1998-1999. Në kërkim të drejtësisë tranzicionale në Kosovë, ne shqiptarët kemi paguar çmim të lartë. Drejtësisë nuk i kemi ikur asnjëherë sepse lufta jonë ishte luftë për liri, barazi e demokraci. Kjo është e vërteta jonë! Jam mirënjohës përjetësisht ndaj secilit prej jush e kështu do të jemi bashkë

gjithmonë!”, ka shkruar Lushtaku në “Facebook”.

Lushtaku është ndaluar të premtën me urdhër të Dhomave të Specializuara të Kosovës (DHSK) me seli në Hagë të Holandës. Ai është intervistuar në zyrat e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) në Fushë-Kosovë. Pas intervistimit, ai është liruar. Megjithatë, hetuesit e Zyrës së Prokurorisë së Specializuar (ZPS) ia kanë konfiskuar telefonin.

Edhe Hajredin Kuçi, pjesëtar i ekipit mbrojtës të ish-eprorit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kadri Veseli, ka konfirmuar se është kontaktuar nga EULEX-i lidhur me punën e tij.

# Analistët ndërkombëtarë: Kosova nuk ka rrugë të shkurtër për anëtarësim në BE

PRISHTINË, 10 MARS - Pushtimi rus i Ukrainës ka rritur vendosmërinë e Evropës për ta mbrojtur arkitekturën e saj të sigurisë dhe demokracinë. Në të njëjtën kohë, shumë politikanë dhe analistë kanë kthyer vëmendjen e tyre kah Ballkani Perëndimor, nga frika e ndikimit rus në një rajon të rrënuar tashmë nga paqëndrueshmëritë politike. Tensionet atje janë të vazhdueshme edhe rreth tri dekada pas shpërbërjes së Jugosllavisë.

Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova janë dy vende që veçohen si më të cenueshme nga disa analistë. E para, për shkak të tensioneve etnike dhe udhëheqësit pro-rus të serbëve, Millorad Dodik, i cili shpreh hapur ambicjet e tij për ndarje nga pjesa tjetër e vendit. "Liria është ajo që na duhet. Nuk kemi nevojë për kolonizatorë. Nuk kemi nevojë për mësues. Ky komb nuk e ka lejuar kurrë veten të jetojë i robëruar", ka thënë Dodik në një tubim para mbështetësve të tij në Banjallukë. Kosova, në anën tjetër, ka çështje të hapura me Serbinë - vendin që ruan lidhje të ngushta me Rusinë dhe është i vetmi në Ballkanin Perëndimor që nuk ka vendosur sanksione kundër saj për shkak të pushtimit të Ukrainës.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë në një nga mbledhjet e fundit të Qeverisë së tij se Serbia me "metodat" e presidentit rus, Vladimir Putin, përbën rrezik për Kosovën. Këtë javë, duke folur në një konferencë rajonale në Prishtinë, ka thënë se në dy vitet e parë të qeverisjes së tij, Serbia ka dërguar katër herë ushtrinë e saj në kufi me Kosovën, ka sponsorizuar terrorizmin dhe ka shpërndarë lajme të rreme për t'i justifikuar veprimet e saj agresive.

Kurti ka thënë se Bashkimi Evropian dhe NATO-ja i janë përgjigjur drejt pushtimit rus të Ukrainës, duke futur Finlandën dhe Suedinë në aleancën ushtarake, dhe duke u dhënë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE, Ukrainës, Moldavisë dhe Gjeorgjisë. "Kërcënimet e sigurisë në Ballkanin Perëndimor nga Serbia duhet të trajtohen me të njëjtën qasje, duke i dhënë Kosovës statusin e vendit kandidat për Bashkimin Evropian dhe anëtarësimin në Këshillin e Evropës", ka thënë Kurti.

Po këtë javë, ministrja e Jashtme e Gjermanisë, Annalena Baerbock, ka thënë se agresioni rus në Ukrainë e ka bërë të domosdoshëm zgjerimin e BE-së me Ballkanin Perëndimor. Kjo, sipas saj, do ta bënte më të fortë edhe Evropën. "Lufta ruse e agresionit nuk bëhet vetëm me bomba, raketa, dronë dhe me sulmet më të këqija kundër popullatës civile në Ukrainë. Ajo përfshin edhe luftën hibride.



Zgjerimi është domosdoshmëri gjeopolitike", ka thënë Baerbock. Gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor - Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina - janë në faza të ndryshme të procesit të pranimit në BE.

Rruga është e gjatë - ato duhet t'i përafrojnë ligjet me ato të BE-së dhe të dëshmojnë se institucionet dhe ekonomitë e tyre i përmbushin normat demokratike. Procesi ka shkuar shumë ngadalë, por pas pushtimit rus të Ukrainës, BE-ja ka ndarë një paketë prej 6 miliardë eurosh për t'i ndihmuar ato si në reforma, ashtu edhe për t'u larguar nga ndikimi rus.

Analistët nuk presin që gjërat të ndryshojnë brenda natës. Thonë se hezitimi për kohë të gjatë i BE-së për t'u zgjeruar - për herë të fundit në vitin 2013 me Kroacinë - ka koston e vet.

Vessela Tcherneva, nga Këshilli Evropian për Marrëdhënie me Jashtë, thotë për programin Expose të Radios Evropa e Lirë se disa vende të rajonit kanë gjetur tashmë partnerë alternativë. "Për shembull, Serbia luan lojën e të zgjedhurit midis BE-së në njërin anë dhe Rusisë dhe Kinës në anën tjetër. Ky trend është në rritje. Dhe, mendoj se politikëbërësit evropianë e kanë të qartë tashmë se paqëndrueshmëria në një rajon, i cili gjeografikisht nuk është vetëm pjesë e kontinentit, por në zemër të kontinentit, mund të jetë shumë, shumë e rrezikshme", thotë Tcherneva.

Në fjalimin për gjendjen e BE-së, të mbajtur në shtator të vitit 2023, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka thënë se BE-ja duhet t'i përgjigjet "thirrjes së historisë" dhe të pranojë një numër të

madh vendesh, përfshirë nga Ballkani Perëndimor. "E ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në Unionin tonë" ka thënë ajo.

Pak ditë para kësaj, presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, ka thënë se BE-ja do të mund të pranojë vende të reja anëtare deri në vitin 2030, por se ato "nuk duhet të importojnë konflikte nga e kaluara".

Për Dimitar Bechevin, profesor në Universitetin e Oksfordit, ky afat është tejet ambicioz. Duke folur për Exposed, ai thotë se deri në fund të dekadës ndoshta vetëm një vend - Mali i Zi - mund të bëhet pjesë e bllokut.

Për Kosovën, e cila është më së largu prej BE-së, ku vetëm ka aplikuar për anëtarësim, Bechev thotë se duhet të përqendrohet në normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë përpara se të flasë për integrimin evropian. Rrugë të shkurtër, sipas tij, nuk ka. "Për fat të keq, ajo që kemi parë për një vit apo një vit e gjysmë në Kosovë, është se si BE-ja ka trajtuar kriza të përsëritura. Në veri të Kosovës ka gjithmonë kriza, tensione, protesta... Kurti po i shton rreziqet tani me çështjen e valutës. Pra, politikëbërësit evropianë, por edhe Shtetet e Bashkuara, që janë, po ashtu, të përfshira në Kosovë, duhet të fillojnë zjarre, në vend se të mendojnë për një zgjidhje përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë", thotë Bechev.

Kosova dhe Serbia e kanë normalizimin e marrëdhënieve kusht për përparim në rrugën e integritit evropian.

Bechev thotë se të gjithë liderët ballkanikë mund të angazhoheshin më shumë në zbatimin e reformave, por shton se BE-ja ka përgjegjësi, gjithashtu, për mungesën e suksesit në procesin e zgjerimit. Sipas tij,

Ballkani Perëndimor ka qenë gjithmonë në agjendë të BE-së, por jo top-agjendë, qoftë për shkak të hezitimit të disa liderëve për t'u zgjeruar, qoftë për shkak të problemeve të brendshme të BE-së.

Sidoqoftë, pas nisjes së luftës në Ukrainë, BE-ja ka marrë disa hapa për ta konsoliduar pozicionin e saj dhe për t'i parandaluar përçarjet në kontinent.

Në Bosnjë-Hercegovinë ka përforcuar misionin e saj paqeruajtës EUFOR, ashtu siç ka bërë edhe në Kosovë me misionin për sundimin e ligjit EULEX. Por, ajo nuk ka arritur ta bindë Serbinë që t'u bashkohet sanksioneve kundër Rusisë.

Bechev thotë se tash për tash qëllim duhet të jetë mbajtja nën kontroll e ndikimit rus në Ballkan, sepse të hiqet qafe plotësisht është e pamundur. "Serbia, e cila është qendër e ndikimit të Rusisë në Ballkanin Perëndimor, do të jetë jashtë BE-së për një të ardhme të parashikueshme. E derisa nuk prishet kjo lidhje, Rusia do t'i ketë gjithmonë disa karta për të luajtur në këtë pjesë të Evropës", thotë Bechev.

Tcherneva, nga Këshilli Evropian për Marrëdhënie me Jashtë, pajtohet, por shton se Bashkimi Evropian duhet të kërkojë mënyra për ta përshpejtuar integrimin e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, pa sugjeruar ndonjë alternativë për zgjerimin, "sepse anëtarësimi në BE ka të bëjë me transparencën, me rregullat, me standardet, me sundimin e ligjit, ndërsa ndikimi rus kalon përmes kanaleve të korrupsionit, kanaleve të pandershme dhe kanaleve të medieve të kontrolluara", thotë Tcherneva.

Në uebfaqen e BE-së thuhet se blloku është "plotësisht i

përkushtuar për integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE. Ky është një objektiv i përbashkët strategjik, që bashkon të gjithë rajonin dhe BE-në".

Në një postim në X më 29 shkurt, komisionari për Zgjerim i BE-së, Oliver Varhelyi, ka shkruar se rajoni i Ballkanit Perëndimor "duhet të avancojë me shpejtësi sa iu përket reformave".

Në raportin e fundit të organizatës Freedom House, që vlerëson fushën e të drejtave politike dhe lirive qytetare, të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor radhiten si pjesërisht të lira.

Sondazhe të ndryshme të opinionit tregojnë se mbështetja publike për anëtarësimin në BE është ndryshe-ndryshe në të gjithë rajonin - Kosova dhe Shqipëria zakonisht kanë rezultate më të larta, ndërsa Serbia më të ulëta.

Një sondazh i kryer nga Ipsos në Serbi, i publikuar në prill të vitit 2022, ka gjetur se 44 për qind e pjesëmarrësve kanë qenë kundër anëtarësimin të Serbisë në BE dhe 35 për qind për. Kjo ka qenë hera e parë që në këtë vend kanë mbizotëruar pikëpamjet negative.

Po atë vit, një sondazh tjetër ka treguar se Mali i Zi është më i mirëprituri në BE, ndërsa Kosova më së paku. Sot kanë kaluar më shumë se dy dekada nga Samiti i Selanikut, ku vendeve të Ballkanit Perëndimor u është premtuar e ardhme evropiane.


Afati i 2030-s që është përmendur nga Charles Michel është mjaft afër për t'i joshur ato që të bëjnë sa më shumë investime politike për t'u përafuar me BE-në. Por, është ndoshta edhe zile zgjimi për vetë BE-në që "thirrja e historisë" të mos shndërrohet në një shans të humbur historik. /REL/

## Për nder të muajit të Ramazanit në Prishtinë dekorohet rruga "Ibrahim Lutfiu"

PRISHTINË, 10 MARS - Komuna e Prishtinës ka dekoduar rrugën "Ibrahim Lutfiu" në prag të muajit të Ramazanit. Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se dekorimi është bërë për t'i dhënë atmosferë të ngrohtë dhe sjellë ndjesinë e festës e bashkimit të Prishtinës në këtë muaj sakrifice.

"Në prag të Muajit të bekuar të Ramazanit, kemi dekoruar rrugën 'Ibrahim Lutfiu' në zonën e vjetër të kryeqytetit, për t'i dhënë atmosferë të ngrohtë dhe sjellë ndjesinë e festës e bashkimit të Prishtinës tonë në këtë muaj sakrifice. Vizituar po ashtu Këshillin e Bashkësisë Islame të

Prishtinës, ku u pritëm nga kreu i KBI-së, Hetem ef. Sopjani me të cilin biseduam për projekte të përbashkëta në interes të qytetarëve. Pamë edhe dizajnin e veçantë të lokalit 'Begler' i cili gjendet në këtë zonë dhe që duhet vizituar patjetër", ka bërë me dije Rama.



## Ngritja e çmimeve në Kosovë, ankohen qytetarët: Nuk ia dilet me 200 euro

PRISHTINË, 10 MARS - Qytetarët ankohen për vazhdimin e rritjes së çmimeve të artikujve ushqimorë, për mirëmbajtje dhe veshmbathje, duke thënë se një gjë e tillë vetëm sa po e rëndon gjendjen e tyre ekonomike.

Qytetarët ankohen për vazhdimin e rritjes së çmimeve të artikujve ushqimorë, për mirëmbajtje dhe veshmbathje, duke thënë se një gjë e tillë vetëm sa po e rëndon gjendjen e tyre ekonomike.

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës është më i lartë në një mesatare prej 2.2-përqindësh në muajin shkurt të këtij viti krahasuar me muajin shkurt 2023, teksa inflacioni mujor ishte 0.1 për qind në shkurt 2024.

Qytetari Zeqir Buzuku thotë për

"KosovaPress" se çmimet e artikujve në përgjithësi janë tejet të larta dhe se me një pension të vogël arrin mezi t'ia dalë. "Për çdo ditë rriten... Me ia dalë disi po ia dalim, se shumë vështirë, sidomos ne që jemi në pension e kemi shumë të vështirë... Askush për neve nuk mendon, sikur të jemi tepriçë teknologjike, përpara ashtu kemi dalë, problem është shumë, zor. Shyqyr që te ne është ende solidariteti mes vete e të ndihmon ndonjë familjar, sepse me një pension nuk ka shanse të jetosh një javë, nuk mundesh më tepër", tha Buzuku.

Edhe Avni Bikliqi thotë se me një pagë 200 euro në ditët e sotme nuk mund t'ia dalësh as për vete dhe se nuk bëhet fjalë për familje e gjëra të tjera. "Deri tani ia kemi dalë, veç më jo. Me 200 euro nuk po ia del. Mua nuk po më del për



veten time e jo edhe për familje e të tjera", ka thënë ai.

Ndërsa qytetari tjetër Miran Kajtazi thotë se 50 për qind e popullatës janë pa punë, ndërkohë që çmimet e artikujve janë rritur 100 për qind, duke rënduar akoma më shumë

gjendjen e tyre ekonomike.

"Çmimet janë të shtrenjta sepse 20 deri në 30 për qind kanë qenë në fillim, tash këtë vit janë 100 për qind të shtrenjta... Ai që punon ia del disi, ai që nuk punon hiç, në përgjithësi. 50 për qind e njerëzve janë të papunë

në Kosovë dhe për ata është edhe vështirë t'ia dalin", ka vijuar Kajtazi.

Mustafë Kastrati shprehet se nuk ka dukuri më të madhe sesa ngritja e çmimeve.

ASK njofton se shtrenjtimi vërehet me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it, energjia elektrike 11.5 për qind, pijet alkoolike 11.2 për qind, pemët 10.1 për qind, peshqit 9.4 për qind, lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet, 8.3 për qind, mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake 7.7 për qind, uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet 6.5 për qind, biletat e fluturimeve 6.3 për qind, sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat 6.2 për qind.

## Mbi 300 raste të reja me kancer brenda dy muajve në Kosovë



PRISHTINË, 10 MARS - Mbi 300 raste të reja me kancer janë shënuar gjatë muajit janar dhe shkurt të këtij viti në Kosovë. Ndërkaq, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, numri i rasteve është rritur për mbi 10 për qind. Derisa kanceri i gjirit vazhdon të dominojë te gratë, te meshkujt ai i mushkërive.

Drejtori i Klinikës së Onkologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), Ilir Kurtishi, në një intervistë për "KosovaPress" thotë se numri i rasteve të reja me kancer është trend në rritje, derisa potencon se pritet që në fillim të muajit majit të përfundojnë renovimet e kësaj klinike.

Kurtishi ka përmendur disa nga faktorët që ndikojnë në shtimin e rasteve me këtë sëmundje malinje, duke përfshirë ata gjenetikë, të ambientit të jashtëm, moshën, gjininë e të tjerë. "Këtë vit në muajin janar kemi regjistruar 150 raste dhe në muajin shkurt rreth 170, pra mbi 310 raste janë për dy muaj. Në krahasim me vitin 2023, me dy muajt e parë, kemi gati rreth 10-12 për qind më shumë dhe ky trend vazhdon të jetë i lartë, njëjtë sikurse vitin e kaluar. Pasi viti 2023 shënoi një numër të lartë të rasteve të reja, për herë të parë në Kosovë, mbi 2 mijë persona. Pra, kemi regjistruar në vitin 2023, 2 130 persona,

ndërsa në vitin 2022 kanë qenë të regjistruar ose të identifikuar dhe të trajtuar në Klinikën e Onkologjisë si raste të reja rreth 1 750 persona. Bëhet fjalë për tumoret tek të rriturit dhe jo për tumoret e fëmijëve dhe jo për tumore thematologjik që trajtohen nga dy klinikat e tjera. Forma më e shpeshtë e këtyre sëmundjeve është kanceri i gjirit që dominon te femrat dhe në përgjithësi është tumori më i shpeshtë, ndërkaq te meshkujt dominon kanceri i mushkërive, kurse menjëherë pas këtyre dy formave të kacereve, prijnë tumoret e zorrës trashë", ka theksuar Kurtishi.

## 12 mjekë specialistë braktisën punën në QKUK në vitin 2023

Prishtinë, 10 mars - Ikja e mjekëve nga Kosova dhe vazhdimi i ushtrimit të profesionit të tyre në vendet e Evropës ka qenë një ndër temat që më së shumti ka ngjallur debat në vend.

E frika se institucionet shëndetësore mund të përballen me mungesë të mjekëve u shtua pasi në

Kosovë hyri në fuqi liberalizimi i vizave. Sipas ekspertëve të ekonomisë, liberalizimi i vizave mund të prekë disa sektorë, ku në mesin e atyre që kërkojnë kushte më të mira të punës mund të jenë edhe mjekët.

Vetëm në vitin 2023 nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës janë larguar 12 mjekë

specialist, numër ky që konsiderohet të jetë i vogël nga Shërbimi Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës.

Nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor, Klinik dhe Universitar i Kosovës, kanë thënë për Telegrafin se kërkesat për punësim janë shumë më të mëdha sesa ikja e mjekëve.



# “Për fundjavë në Evropë”, bizneset ankohen se u ka rënë puna



PRISHTINË, 10 MARS - “Çdo i treti kalimtar në qendër të Selanikut fliste shqip”, thotë me shaka Sedat Kiçmari. Me gruan dhe dy fëmijët, ai vizitoi qytetin bregdetar të Greqisë fundjavën e fundit të shkurtit.

Ishte hera e parë që familja katëranëtarëshe udhëtoi pa viza në një vend të Bashkimit Evropian.

Qytetarët e Kosovës e gëzojnë këtë të drejtë nga 1 janari i këtij viti dhe disa përfaqësues biznesesh ankohen se “euforia e madhe” për të udhëtuar i ka lënë me më pak punë e më pak të ardhura. Nëse trendi vazhdon, disa biznese edhe mund të mbyllën, thotë kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna.

Ruzhdi Kurtishaj, pronar i agjencisë turistike “Sharr Travel”, thotë se udhëtimet e qytetarëve të Kosovës nga 1 janari e kënde janë shtuar për më shumë se 100 %.

Agjencia e tij operon me dhjetëra autobusë që realizojnë udhëtime çdo ditë.

Destinacionet thotë se janë të ndryshme: Greqi, Kroaci, Hungari, Bullgari e Austri. “Po e marr shembull Greqinë, pasi është vendi më i frekuentuar. Vitin e kaluar në këtë shtet kemi udhëtuar një herë në javë me një autobus, ndërsa aktualisht udhëtojmë tri herë në javë me gjashtë autobusë”, tregon Kurtishaj për Radion Evropa e Lirë.

Ai thotë se kapaciteti i një autobusi është për 50 deri në 80 udhëtarë, ndërsa bileta kthyesë nga Prishtina deri në Selanik -

rreth 330 kilometra larg - është 20 euro.

Nëse bëhet llogaritja vetëm me shifrat e kësaj agjencie, i bie që së paku 300 qytetarë udhëtojnë çdo javë drejt Greqisë dhe vetëm për bileta shpenzojnë së paku 6 000 euro.

Në Kosovë janë të regjistruara 757 biznese - përfshirë agjenci udhëtimi, operatorë turistikë e të tjera - që merren me turizëm. Të dhënat që REL-i siguroi nga Policia e Kosovës tregojnë se nga 1 janari deri më 21 shkurt të këtij viti, mbi 1.7 milion qytetarë kanë dalë nga kufiri tokësor i Kosovës, ndërsa kanë hyrë mbi 1.6 milion.

Shifrat përfshijnë edhe ata qytetarë që kanë lëvizur më shumë se një herë.

Megjithatë, policia nuk dha të dhëna për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kur për qytetarët e Kosovës nuk vlente liberalizimi i vizave.

Në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, ndërkaq, konfirmojnë se ka rritje të numrit të udhëtarëve në dhe nga Kosova.

Zëdhënësja Valentina Gara thotë se numri i përgjithshëm i tyre në muajin janar ka qenë mbi 287 mijë, krahasuar me mbi 266 mijë sa ka qenë në janar të vitit 2023.

Kiçmari, i cili me profesion është kontabilist, thotë se për një fundjavë në Selanik ka shpenzuar rreth 400 euro, “përfshirë këtu sigurimin për makinën me të cilën kanë udhëtuar, akomodimin, ushqimin dhe aktivitete të tjera”.

Nga përvoja e kaluar thotë se çdo shpenzim ia ka vlejtur. “Qytet i bukur, kishte vende të ndryshme turistike për t’u vizituar”, thotë ai.

Por, përshtypje si këto kanë ndikuar në turizmin e brendshëm.

Hysen Sogojeva, udhëheqës i Odës së Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës, thotë se dy muajt e fundit nuk janë të krahasueshëm me periudhat e njëjta të viteve të kaluara. Në këtë kohë, thotë ai, kur vendet malore dhe restorantet në natyrë do të duhej të frekuentoheshin masivisht në fundjavë, kanë dukshëm më pak klientë. “Po presim që muajve të ardhshëm të stabilizohet situata... Shpresojmë që kjo eufori e qytetarëve [për të dalë jashtë] është afatshkurtër, vetëm nga kureshtja e lëvizjes pa viza”, thotë ai.

Deklaratave të tij u bënë jehonë edhe Sadik Gashi, i cili udhëheq pushimoren “Holiday Resort” në fshatin Sllatinë të Prishtinës.

“Rënie të numrit të klientëve ka sidomos gjatë fundjavës, por edhe ditëve të tjera”, thotë ai. “Ata, kur po shkojnë gjatë fundjavave në Selanik, Romë apo ndonjë shtet tjetër... qarkullimi ditor bie edhe gjatë ditëve të tjera të javës, sepse paratë i shpenzojnë jashtë dhe nuk kanë më mundësi t’i vizitojnë restorantet në Kosovë”, shton Gashi.

Përveç në hoteleri e gastronomi, rënie të klientëve duket se kanë edhe kompanitë e derivateve të naftës. “Deri në 30

për qind ka rënë shitja krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar”, thotë Avdi Avdiu, pronar i kompanisë “Universal” në Mitrovicë të Jugut. “Përqindja mund të jetë edhe më e lartë por, për fat, kjo pikë furnizon me derivate të naftës disa autobusë të agjencive turistike në Mitrovicë. Këta e kanë rritur sasinë e shpenzimeve, pasi udhëtojnë më shpesh jashtë Kosovës. Furnizohen me sasi deri në tri herë më shumë se vitin e kaluar”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, thotë se kjo situatë i shkakton pasoja të pashmangshme ekonomisë, përkatësisht aktivitetit të bizneseve. Për një fundjavë, sipas tij, një familje shpenzon mesatarisht 600 deri në 800 euro jashtë Kosovës, “varësisht nga shteti që viziton”. Kjo, pastaj, ul kërkesën e konsumit në Kosovë, sepse paratë e gatshme shpenzohen jashtë, thotë Rafuna.

Nëse ky trend vazhdon, sipas tij, bizneset do të obligohen t’i largojnë punëtorët nga puna, madje “disa edhe mund të mbyllën, sepse biznesi themelohet të gjenerojë fitim dhe jo të humbë”, thotë ai.

Sogojeva, nga Oda e Hotelierisë dhe Turizmit, shpreh shqetësim për mungesë punëtorësh në të ardhmen e afërt - edhe pse kjo ka qenë një sfidë e vazhdueshme në Kosovë me vite. “Problemet mund paraqiten në muajt vijues, sidomos në prill dhe maj, kur

rritet puna në shtetet e Evropës dhe krijohen vende të reja të punës. Atëherë qytetarët mund të gjejnë alternativa për të punuar në Perëndim”, thotë Sogojeva.

Liberalizimi i vizave, megjithatë, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime punësimit, por vetëm vizita turistike.

Për punësim në një vend të BE-së duhen vizë dhe leje e posaçme.

Kosova ka qenë e fundit në rajonin e Ballkanit Perëndimor që fitoi të drejtën e lëvizjes së lirë.

Duke iu përgjigjur interesimit të REL-it për këtë temë, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ku gjendet edhe Departamenti për Turizmin, tha se nuk ka bërë ndonjë hulumtim për ndikimin e liberalizimit të vizave në sektorin e turizmit.

Kosova - me 1.7 milion banorë dhe me pagë mesatare 520 euro - është e ndarë në pesë rajone turistike: rajoni qendror i Prishtinës; rajoni turistik i Alpeve Shqiptare - Beshkët e Nemuna; rajoni turistik i Sharrit; rajoni turistik i Anamoravës dhe rajoni turistik i Mitrovicës.

Por, përfaqësues të organizatave që merren me promovimin e turizmit në vend, kanë thënë më herët për REL-in se ky sektor nuk është zhvilluar sa duhet. Kiçmari thotë se mezi pret të nisët për në destinacionin e radhës, edhe pse pas kthimit nga Greqia “i është dashur t’i kufizojë shpenzimet për disa ditë”.

# Na pret e ardhmja fashiste dhe totalitare



Nga: **Jordan PETERSON**, profesor kanadez, autor, psikolog klinik dhe kritik i çështjeve kulturore dhe mediave / *The Daily Telegraph*  
Përkthimi: **Agron SHALA** / *Telegrafi.com*

Në Kinën komuniste sot janë 700 milionë CCTV [kamera vëzhgimi]. Ata sy elektronikë janë të lidhur me aparatit më të kompletuar shtetëror të mbikëqyrjes që mund të paramendohet. Ka aftësinë jo vetëm të njohë fytyrat në largësi, por të veprojë kur tiparet e fytyrës janë të fshehura ose të errësuar. Aftësia e tillë mundet, dhe së shpejti do t'ia dalë, të arrijë në pikën ku vetë lëvizjet e syve – të monitoruara nga kamerat inteligjente – do të mjaftojnë për të identifikuar çdo palë aktive.

Inxhinierët e çmendur dhe naivë që me kaq entuziazëm ndihmuan në ndërtimin e këtij sistemi, këtë e quajnë “SkyNet” – sipas teknologjisë keqbërëse dhe gjithëpërfshirëse që merr kthesë kaq të tmerrshme e të gabuar në serinë e fantashkencës Terminator, ku robotët me inteligjencë artificiale bëjnë gjithçka për ta

mbrojtur veten dhe për pasojë e shkatërrojnë njerëzimin. Emri gjithashtu i referohet një fraze të njohur kineze që përshkruan shtrirjen e vetë hyjnore – “rrjeta e parajsës është e pafund, megjithatë nuk i mungon asgjë” – që tamam e përshkruan aftësinë e aparatit të ri shtetëror

Ky sistem është i integruar në të ashtuquajturin Sistemi Kinez i Kredisë Sociale, i cili pjesëmarrësit e pavullnetshëm i shpërblen me pikën që bën me dije për përputhshmërinë e tyre me diktatet e Partisë, duke e lejuar kontrollin e plotë mbi qasjen në gjithçka që ata posedojnë në formën elektronike, më e keqja në kursimet e tyre dhe qasjen në udhëtime, përfshirë këtu – meqë po shfaqen më shumë porta elektronike – edhe lëvizjen.

Nëse je kinez apo thjesht vizitor, nëse Rezultati yt i Kreditit Social bie përtej minimumit arbitrar, qasja jote në botë mund të reduktohet në zero. Kjo e lejon përjashtimin tënd nga të gjitha aktivitetet që mund të virtualizohen: ngasje, pazar, punë, ushqim, gjetje strehimi; madje edhe shoqërimi me miqtë dhe

familjen (meqë thjesht je në prani të dikujt me Rezultat të ulët të Kreditit Social, kjo do të thotë se rezultati yt mund të zbrësë).

Kjo ia ka hapur mundësinë qeverisë që të përfitojë – nga qytetarët e vet – fuqi punëtore të ngjashme me skllëverit. Dhurimi i punës falas për shtetin përbën mjetin me të cilin qytetarët mëkatar mund ta rrisin rezultatin e vet dhe të mbeten pjesë e shoqërisë. Për më tiranikët, ky pikërisht është sistemi më i dëshiruar i pagesave: jo “puno për mua dhe përfito nga ajo” që përbën marrëveshjen kontraktuale të ndërmarrë nga qytetarët e lirë, por “puno për mua dhe unë do ta heq privimin që ta vendosa” që gjithmonë ka qenë lajtmotiv i skllavit.

## Bota distopike e krijimit tonë

Pse gjithë kjo ka rëndësi për njerëzit në Perëndim? Sepse, teknologjia që përdor Partia Komuniste Kineze është zgjerim i teknologjisë perëndimore. Sepse, kohët e fundit kemi rënë pre e tundimit të tmerrshëm ndaj mbylljeve të përdorura

nga ai shtet përballë ndonjë krize hipotetike.

Sepse po ecim, hap pas hapi, në të njëjtin drejtim – pjesërisht për shkak të “komfortit” hipotetik të njohjes universale dhe automatike të identitetit, pjesërisht sepse cilido problem që na ballafaqon tash lehtësisht mund të përdoret për të justifikuar shtrirjen shtesë të sigurisë dhe të dado-shtetit. Thuhet se njerëzit e epokës së gurit, të përballur për herë të parë me kamerat dhe pamjet e tyre të zhvilluara nga antropologët modernë, kundërshtuan kapjen e imazheve meqë kishin frikë nga robërimi i shpirtave të tyre. Del se frika e tillë ishte parashikuese: imazhet që lëmë pas gjatë lundrimit nëpër hapësirën virtuale, janë duplikate aq të afërta të vetes sonë aktuale, saqë – në këtë aspekt – kapja e thelbit tonë është thjesht e garantuar.

Të gjithë ne tashmë i kemi kipcat tanë. Të gjithë ne aq shumë jetojmë në botën virtuale – falë zakoneve tona të blerjes dhe mënyrave të komunikimit me ndërmjetësim elektronik – saqë vetja jonë është reduktuar në shkallë të frikshme, thjesht në “data”

[informatë], në ekuivalentin modern të gjurmës sonë, në të njëjtat informata që përbëjnë imazhin e identitetit tonë. Ky identitet mund të blihet dhe të shitet gjithnjë e më shumë nga ndërmjetësit e korporatave të padukshme të cilët atë e përdorin për të na shitur atë që e duam kaq shumë – me mospërfillje dhe lehtësisht – por, që mund të përdoret gjithashtu për të gjurmuar, monitoruar dhe ndëshkuar gjithçka që bëjmë dhe themi. Shkencëtarët bihejvioristë e ndihmojnë këtë proces përmes zgjedhjes që ndryshon sjelljen: praktikën e shtyrjes së njerëzve në një drejtim të caktuar ideologjik, duke manipuluar stimujt e padukshëm prapa skenave. Korporatat ndjekin vendimet e blerjes duke zhvilluar algoritmet të cilat – përmes saktësisë që rritet – ndjekin modelet tona të vëmendjes dhe të veprimt, duke mundësuar kështu parashikimin e asaj që më pas mund të bëhet më tërheqëse, duke e bërë këtë jo vetëm për të na ofruar atë që duam, por për të përcaktuar dhe formësuar atë që neve na nevojitet. Qeveritë munden dhe po bashkëpunojnë që me këta



agjentë të korporatave të krijojnë tablonë jo vetëm të veprimeve tona, por të mendimit dhe të fjalëve tona, në mënyrë që të mund të hartohet devijimi drejt përfundimit të dëshiruar, drejt shpërblimit dhe ndëshkimit. Zhvillimi i identitetit dhe valutës së tillë dixhitale nuk është asgjë tjetër veçse pasoja e mundshme përfundimtare e prirjeve të tilla – dhe kombinimi i të dyjave do të lehtësojë zhvillimin e një shteti mbikëqyrës, shtrirjen e të cilit vështirë se mund ta imagjinojnë pesimistët optimistë të totalitarizmit, si George Orwell.

### Marrëveshje e fundit e fshehtë fashiste

Sistemet e reja të AI-së [inteligjencës artificiale] që me shpejtësi po shfaqen, nuk bëjnë asgjë tjetër veçse e shtojnë këtë rrezik, duke e ofruar mundësinë e super-mbikëqyrjes fushëveprimi i së cilës tejkalon çdo gjë që njerëzit e thjeshtë – të pandikuar nga teknologjia – mund të

paramendojnë. Ato mund të jenë të sigurta se qëndrimet, sjellja dhe personalitetet tona do të manipulohen deri në atë shkallë sa që nuk do të jemi më në gjendje të shohim ndonjë realitet tjetër jashtë atij që është ndërtuar nga supershteti: marrëveshja e fshehtë përfundimtare fashiste midis korporatave gjigante – me interesa personale – dhe obsesionit paranojak për sigurinë të qeverive antinjerëzore.

Për qëllimet e kënaqësisë dhe të komfortit të menjëhershëm, shpirtin tashmë po ia shesim supershtetit, ndërkohë që për këtë joshemi nga ideologët që nxisin frikën duke na e garantuar sigurinë të cilën kaq dëshpërimisht dhe gjithnjë e më shumë e dëshirojmë.

Kjo aspak nuk është çështje partiake. Në vendin tim, në Kanada, tejkalimi më skandaloz i supershtetit ndodhi si pasojë e një proteste të klasës punëtore kundër – dhe për ironi – tejkalimeve të shtetit gjatë bllokimeve të Kovidit, kur qeveria jonë federale, gjithnjë e më

delirante dhe totalitare, vendosi – në bashkëpunim me bankat e mëdha kanadeze – se ishte e përshtatshme të pezullonte qasjen e protestuesve dhe të mbështetësve të tyre, sado të paktë, në vetë asetet që kanë. Ngjarja e tillë frikësoi – dhe do të duhej – këdo që merret me mbrojtjen e sigurisë personale, të privatësisë dhe autonomisë, duke sinjalizuar aftësinë dhe vullnetin gjithnjë e më të madh të agjentëve shtetërorë dhe të korporatave për të vepruar në sinkron – përkitazi me të dhënat që tani zotërojnë, mjetet e kontrollit që kanë në dispozicion, dhe për të ndëshkuar klientët dhe qytetarët për pikëpamjet e tyre politike, sado pak të përhapura qofshin ato pikëpamje. Pikëpamjet që konsiderohen të papranueshme, saktësisht përcaktohen si ato që kundërshtojnë interesat e kujtdo që aktualisht mban stafetën e pushtetit, të majtë apo të djathtë, korporativ apo qeveritar.

Kohët e fundit, në Kanada u tha se veprimi i tillë fjalë për

fjalë ishte antikushtetues. Por, kjo nuk e ka ndaluar shtrirjen e tepërt të shtetit. Legjislacioni i ri i propozuar nga e njëjta qeveri mandaton gjenerimin e një burokracie gjigante që së shpejti do të monitorojë dhe do të ndëshkojë – në mënyrë jashtëgjyqësore – të ashtuquajturat “krime të urrejtjes”, me çfarë së shpejti do të përshkruhet çdo fjalim ose veprim të cilin e kundërshtojnë burokratët dhe korporatat të cilat vetë janë përgjegjëse për atë përkufizimin.

I njëjti legjislacion tani madje e përcakton atë që mund të konsiderohet si para-krim: nëse një agjent gjykatë gjykon se një shtetas kanadez mund të kryejë të ashtuquajturin krim të urrejtjes në të ardhmen, ai person mund të pajiset me një pajisje mbikëqyrëse elektronike që kufizohet në aftësinë e tij ose të saj për të lëvizur ose komunikuar, për të monitoruar kështu përputhjen e tyre me diktatet e shtetit.

Me rritjen e aftësisë për të monitoruar jo vetëm modelet aktuale të vëmendjes dhe

sjelljet e qytetarëve, por edhe për të parashikuar gjërat që janë më të mundshme, bëhet gjithnjë e më i mundshëm persekutimi i krimit të tillë të mundshëm. “Nëse nuk keni asgjë për të fshehur, nuk do keni asgjë për t’u frikësuar”, do të jetë slogani i komanduar nga ata që me shumë gjasë do t’i drejtohen mbikëqyrjes – për të mbrojtur dhe për të kontrolluar. Cila ishte shakaja më e famshme totalitare sovjetike, që i atribuohet Lavrentiy Berias, kreut të policisë sekrete? “Ma trego njeriun dhe unë do të ta tregoj krimin”. Ato fjalë ishin mjaft të vërteta në kohën e terrorit të Josif Stalinit – dhe, edhe atëherë policia ishte mjaft sekrete. Por, kjo nuk është asgjë në krahasim me atë që ne mund të prodhojmë dhe me gjasë do të prodhojmë tani: një polici kaq sekrete sa që nuk do të jemi në gjendje të zbulojmë as aktivitetin e tyre gjithëpërfshirës dhe delikat që aq thellë monitoron krimin, sa që që të gjithë nën diktatin e sistemit do të kenë diçka për të fshehur dhe shumëçka për t’u frikësuar. /Telegrafi/



**EURO GLASS**  
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
 Invert  
 Adr: Fushë Kosovë  
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
 E-mail: euro.glass@live.com



## Sadiku: Bëra realitet një ëndërr, shihemi në Paris

**PRISHTINË, 10 MARS** - Donjeta Sadiku është shprehur e lumtur pasi siguroi biletën për në Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Përmes një postimi në rrjetet sociale, ajo theksoi se "i është realizuar një ëndërr". Donjeta gjithashtu premtoi se do të bëjë më të mirë edhe në Paris, në mënyrë që edhe atje të ketë arsye për të

festuar. Mes tjerash, boksierja kosovare në veçanti falënderoi trajneren e saj, Marjola Sallauka, familjen e vet dhe të gjithë ata që e përkrahen. "Një ëndërr mu bë realitet, shumë punë, mund e sakrificë që më ka përcjellë gjatë kësaj periudhe, u shpërblyen në mënyrën e duhur e në kohën e duhur. Shumë momente gëzimi

e krenarie përjetuam së bashku, ju premtoj që do bëjë më të mirën që të festojmë edhe në Paris. Falënderuese përjetësisht trajneres time Marjola Sallauka, familjes time dhe të gjithë ata që më mbështetën gjatë këtij rrugëtimi. Rruga nuk përfundon këtu shihemi në 'Paris 2024'", ka shkruar Sadiku.



## Ylli fiton derbin ndaj Prishtinës, Bashkimi nuk gabon ndaj Istogut

### "Epoka e re"

**PRISHTINË, 10 MARS** - Pas vazhdimëve, Golden Eagle Ylli shënoi fitore ndaj Sigal Prishtinës me rezultat 103:95 (17:26, 24:25, 25:15, 19:19, 18:10), në javën e 24-t të Prince Caffè Superligës. Skuadra mysafire e filloi më mirë ndeshjen dhe çerekun e parë kishin epërsi deri në 11 pikë, 15:26, derisa kjo pjesë përfundoi 17:26. Bardhekaltrit epërsinë më të lartë e kishin 14 pikë, 19:33, derisa periudha e dytë u karakterizua si e barabartë, ku pjesa e parë përfundon 41:51. Megjithatë, therandasisit u rikthyen në periodën e tretë, ku në fund të kësaj pjese barazojnë rezultatin në 66:66. Lojë



interesante e me kthesa u zhvillua në çerekun e katërt, ku bardhekaltrit në fund po fitonin 80:82, por vendasit me pesë pikë radhazi kaluan në epërsi 85:82,

kurse Henrik Sirko me një treshe barazoi shifrat në 85:85, 38 sekonda nga fundi, që ishte rezultati përfundimtar i ndeshjes, pasi dy skuadrat nuk shënuan

dhe sfida shkoi në vazhdim, ku Jan Palokaj shënoi tre treshe dhe ishte vendimtar në fitoren e Yllit me rezultat 103:95. Te Golden Eagle Ylli më të mirët ishin Alonzo Verge Jr me 37 pikë, pesë kërcime e tetë asistime, Jan Palokaj me 21 pikë dhe Nate Grimes me 21 pikë e 13 kërcime, kurse te Sigal Prishtina më i miri ishte Diamond Stone me 28 pikë, nëntë kërcime e gjashtë asistime. Golden Eagle Ylli tani renditet në vendin e tretë me 15 fitore e nëntë humbje, derisa Sigal Prishtina e katërta me 14 fitore e dhjetë humbje. Bashkimi shënoi fitore ndaj Istogut me rezultat 128:65 (34:12, 32:20, 21:18, 41:15). Prizrenasit nga fillimi deri në fund ishin më të mirë, për të shënuar fitore bindëse, ndaj

istogasve që kanë vetëm një fitore në këtë edicion dhe atë e kanë pikërisht kundër Portokallezinjëve. Istogasit numërojnë edhe 23 humbje, kurse prizrenasit janë në vendin e gjashtë me nëntë fitore e 15 humbje. Erik Copes ishte më i miri te Bashkimi me 21 pikë e nëntë kërcime, derisa te istogasit, Arian Azemi kishte 28 pikë e gjashtë kërcime dhe Donat Rexhepi 20 pikë e gjashtë kërcime. Në një dramë të vërtetë, Vëllaznimi ka mundur Proton Cable Prizrenin me rezultat 85:87 (30:24, 20:17, 21:28, 14:18). Trepça ka shënuar fitoren e 17-të radhazi në Prince Caffè Superligë, duke triumfuar në derbin ndaj Pejës me rezultat 94:77 (24:16, 27:27, 23:16, 20:18)

## Ballkani mposhti Malishevën, Feronikeli 74 shijon fitoren e parë në pranverë

**SUHAREKË, 10 MARS** - Ballkani vazhdon të mbetet në krye të tabelës në Albi Mall Superligë edhe pas javës së 24-t. Vetëm 24 orë pasi Llapi rrëmbeu përkohësisht pozitën e liderit, skuadra portokalleze nga Suhareka realizoi një fitore të sigurt si vendase ndaj Malishevës, me rezultatin 2-0, e cila ia mundëson qëndrimin në pozitën e parë edhe pas kësaj jave, me një pikë më shumë se skuadra llapjane. Golat u shënuan nga Nazmi Gripshi dhe Mamadou Danfa në pjesën e dytë. Këtë

ndeshje nga afër e ndoqi edhe përzgjedhësi i Kombëtares së Kosovës, Franco Foda. Në ndeshjen tjetër, Feronikeli '74 triumfoi në udhëtim ndaj Lirisë, po ashtu me rezultat 2-0. Golat e fitores së parë të skuadrës së drejtuar nga Shefki Kuqi u shënuan nga Robert Rrahmani dhe Ibrahim Cervadiku në pjesën e dytë. Ky rezultat i jep vlerë Feronikelit 74 për paraqitjen e mirë në fushë gjatë këtij stinori, ndërsa Liria vazhdon të mbetet në pozitën e fundit me vetëm 10 pikë të grumbulluara.



SUPERLIGA		
Ballkani - Malisheva		2-0
Liria - Feronikeli 74		0-2
Llapi - Gjilani		2-1
Dukagjini - Fushë Kosova		0-0
Drita - Prishtina		1-0
Tabela		
1. Ballkani	24	51
2. Llapi	24	50
3. Drita	24	46
4. Malisheva	24	41
5. Prishtina	24	34
6. Dukagjini	24	31
7. Feronikeli 74	24	26
8. Gjilani	24	22
9. Fushë Kosova	24	16
10. Liria	24	10

## Liverpooli e City ndajnë pikët në "finalen" e titullit

Liverpool, 10 mars - Super duelin për titullin mes Liverpoolit dhe Manchester City u mbyllë në barazim 1-1 në "Anfield". Një 90 minutësh që prodhoi spektakël të jashtëzakonshëm, teksa të dyja

skuadrat tentuan deri në fund të fitonin ndeshjen. Miqtë kaluan të parët në avantazh me anë të John Stones në minutën e 23-të. Mesfushori përfitoi nga një goditje këndi e ekzekutuar nga De Bruyne dhe

befasoi portierin Kelleher. Liverpooli tentoi në disa raste dhe iu afrua golit, të cilin në fakt e gjeti vetëm në fillimin e pjesës së dytë. Ake gaboi me një top të kthyer në drejtim të Ederson dhe Nunez përfitoi duke i marrë

një penallti brazilianit. Nga pika e bardhë Mac Allister shënoi dhe barazoi ndeshjen. Arsenali për momentin mban kreun me 66 pikë, ndjekur nga Liverpooli mbetet me 64 pikë në vendin e dytë, dhe City me 63 pikë.





K.R.U. "Drini i Bardhë" SH.A  
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85  
www.krudinibardhe.com

Në bazë të nenit 21 paragrafi 21.4 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr.03/L-087, si dhe Plotesim Ndryshimi i Ligjit mbi NP Nr.04/L-111 si dhe Kodi Etikes dhe Qeverisjes Korporative, Bordi i Drejtorëve të K.R.U "Drini i Bardhë" SH.A në mbledhjen e mbajtur më date 05.03..2024, vendosi të publikoi këtë:

## KONKURS

**Për plotësimin e pozitës:**

**Sekretar/-e**

I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Vendi i Punës: Pejë.

Paga: Sipas rregullores se pagave ne fuqi..

Kohëzgjatja e emërimit: Mandati për pozitën e Sekretar/e është 3 vjeçar, me punë provuese 6 muaj.

**Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:**

Përveç detyrave të parapara më ligj, Statutin e Kompanisë, dhe Rregulloren e mirësjelljes,

Detyrat e punës janë:

- Merret me organizimin e takimeve të Bordit, Komisionit të Auditimit dhe Aksionarit duke përfshirë përgatitjen dhe shpërndarjen e agjendave.
- Mban regjistrin e aksioneve,
- Kryen arkivimet, publikimet të përcaktuara më Statutin e Kompanisë,
- Mbikëqyrë mirëmbajtjen e duhur dhe azhurnimin e rregullt të ueb faqes se Kompanisë,
- Merret me regjistrimin zyrtar të ndryshimeve të cilat kërkohen sipas ligjit të regjistohen në regjistrin e Kosovës për shoqëritë Tregtare dhe emrat tregtarë,
- Mban procesverbalet e secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit dhe i shënon ato në librin e Protokollit dhe shpërndan procesverbalet tek drejtorët dhe aksionari,
- Bashkëpunon më institucionet, Ministrinë e Ekonomisë posaçërisht më Njësinë e monitorimit të N.P.
- Lëshon kopje të certifikuara të procesverbaleve.
- Është përgjegjës për vulën e Ndërmarrjes dhe kur kërkohet vulosja e ndonjë dokumenti të nënshkruar nga një nënshkruer i autorizuar,
- Merret me çështje tjera të qeverisjes korporative sipas nevojës,
- Kryen edhe pune tjera sipas direktivave të BtëD dhe KE-se,
- Nivelin e pagës dhe vendimin për emërim dhe shkarkim e bien Bordi i Drejtorëve i Kompanisë.
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Bordit të Drejtorëve dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

**Kushtet për themelimin të marrëdhënës së punës janë:**

- ✓ Fakulteti juridik drejtimi i përgjithshëm me te pakten 240 kredi ECTS ose ekuivalente
- ✓ Përvoja e punës 5 vjeçare në profesion,
- ✓ Njohja e punës më kompjuter, Word, Excel., etj,
- ✓ Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punoj nën presion, të ketë moral të forte për punë dhe integritet të nivelit të lartë,

Niveli i pagesë i rregulluar në bazë të rregullores ne fuqi.

Aplikacioni merret në zyrat e "DRINIT TË BARDHË" në rrugën "Mbretëresha Teutë", nr. 85 në Pejë.

Aplikacionit për pozitën e Sekretar/e duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ne (Biografinë),
- Kopjen e letërnjoftimit, ,
- Diplomën e fakultetit – kopje, Diplom nga universitetet e huaja te jene të Noterizuara,nga MASHTI:
- Certifikatë që nuk është nënë hetime dhe
- Dëshminë e përvojës së punës.

**Për plotësimin e pozitës:**

**1. Inxhener/e i. e Ndërtimtarisë.**

**I përgjigjet:** Kryeshefit Ekzekutiv.

**Vendi i Punës:** Pejë. Një pozite (1).

**Paga:** Në pajtim me rregulloret në fuqi.

**Kohëzgjatja e emërimit:** me kohe të caktuar 3 vite me mundesi vazhdimi **me punë provuese 6 muaj.**

**Detyrat e punës:**

Përveç detyrave të parapara më ligj, Statutin e Kompanisë, dhe Rregulloren e mirësjelljes,

**Detyrat e punës janë:**

- Përpilimin e Projekteve,
- Përgatitjen e ofertave për procedura të prokurimit,
- Ben përgatitjen e objekteve të ujitjes ne fillim te sezonës dhe ne mbarim përgatitja për dimër, Si dhe punët profesionale për çështje teknike,
- Përpilon Raportin e gjendjes në objekte , zgjedhjet e nevojshme dhe mbikëqyrja e kryerjes së punëve në objektet e Kompanisë,
- Të kryej edhe punë tjera sipas direktivave të KE,
- Për punën e tij/saj i përgjigjet KE.

Kushtet për lidhjen e marrëdhënës së punës:

- ✓ Fakulteti i Ndërtimtarisë,
- ✓ Përvoja e punës prej 3 vjet në profesion,
- ✓ Njohja e punës më kompjuter programet, Word,,Excel,etj,
- ✓ Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punoj nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë,
- ✓ Vendimin për themelimin e marrëdhënës së punës e merr Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë.

**Pozita: Menaxher i njësisë operative Vendi Istog (1 pozitë) dhe Deçan (1 pozitë).**

**Paga:** Në pajtim me rregulloret në fuqi.

**Kohëzgjatja e emërimit:** me kohe të caktuar 3 vite me mundesi vazhdimi **me punë provuese 6 muaj.**

**Detyrat e punës janë:**

- Menaxhon më njësinë operative, harton propozim planin vjetor të punës dhe kujdeset për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e aseteve, përcjell realizimin e planit vjetor, është përgjegjës për disiplinën në punë dhe azhurnimin brenda njësisë.

**Kushtet për themelimin e marrëdhënës së punës:**

- Diploma universitare drejtimi ekonomik, bujqësisë ose juridik,
- Përvoja e punës prej 3 viteve në vende të ngjashme të punës.

Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit, dëshminë e përvojës se punës,
- Diplomën e fakultetit te ndertimtarisë për kualifikimin e kërkuar - kopje,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj.

**Pozita: Inkasant vendi: Pejë 3 Puntor & Deçan 2 Punëtor Junik 1 Puntor me kontrate 1 vjeqare. Në Istog 2 Puntor Sezonal**

**Detyrat e punës janë:**

- Duhet të jete ne gatishmëri 24 orë, ndaj kërkesave të hurdhave dhe seperacioneve për shërbimet të cilat i ofron kompania ndaj tyre.

**Kushtet për themelimin e marrëdhënës së punës.**

- Kualifikimi shkollor - fillor - mesëm
- Përvoja e punës, ne lami të ngjashme.

**Procedura e aplikimit:**

Dokumentet dorëzohen ne zyrën nr. 1 të KRU "Drini i Bardhë" rruga "Mbretëresha Teutë" Nr. 85 Pejë.

Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit, dëshminë e përvojës se punës,
- Diplomën shkollore fillor apo te mesme për kualifikimin e kërkuar - kopje,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj.

**Procedura për aplikim:**

Aplikacionet e kompletuara sipas këtij konkursi dërgohen në Zyren e Asistentes Administrative NP. K.R.U"Drini i Bardhë"SH.A në adresën Rr." Mbretëresha Teutë"Nr.85 Pejë, konkursi është i hapur nga data 11/03/2024, deri me 31/03/2024, aplikacionet mund të dorzohen nga ora 8,00 deri në ora 16,00.

**Paraqitja e kërkesave:**

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Kandidatët të cilët do të jenë të përzgjedhur dhe të ftuar në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale..



K.R.U. "Drini i Bardhë" SH.A  
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85  
www.krudriniibardhe.com

Na osnovu člana 21 stav 21.4 Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087, kao i izmene i dopune Zakona o privatnom preduzeću br. 04/L-111 kao i kodeksa etike i korporativnog upravljanja,

Upravni odbor K.R.U "Drini I Bardhe" S.A. na sednici održanoj 05.03.2024. godine, odlučio je da objavi ovo:

### K O N K U R S

**Da popunite poziciju:**

#### Sekretar

Odgovori: Upravnom odboru i Izvršnom direktoru.

Mesto rada: Peć.

Plata: Prema važećem pravilniku o platama..

Trajanje imenovanja: Mandat za funkciju sekretara je 3 godine, sa probnim radom od 6 meseci.

**Glavne dužnosti i odgovornosti:**

Pored obaveza predviđenih zakonom, Statutom Društva i Kodeksom ponašanja,

**Radne obaveze su:**

Bavi se organizacijom odbora, odbora za reviziju i sastanaka akcionara, uključujući pripremu i distribuciju dnevnih reda.

vodi berzanski registar,

Vrši arhiviranje, publikacije definisane Statutom Društva,

Nadgleda pravilno održavanje i redovno ažuriranje veb stranice Kompanije,

Bavi se zvaničnom registracijom promena koje se po zakonu zahtevaju da budu registrovane u kosovskom registru za komercijalna preduzeća i trgovačka imena,

Vodi zapisnik sa svake sednice Odbora direktora i komisija za reviziju i evidentira ih u Zapisnik i dostavlja zapisnik direktorima i akcionarima,

Sarađuje sa institucijama Ministarstva za ekonomski razvoj, posebno sa Jedinicom za monitoring N.P.

Izdaje ovjerene kopije zapisnika.

Odgovoran je za pečat preduzeća i kada je potreban pečat bilo kog dokumenta potpisanog od strane ovlašćenog potpisnika,

Bavi se drugim pitanjima korporativnog upravljanja po potrebi,

obavlja i druge poslove prema direktivama Svetske banke i EK,

Visinu plata i odluku o imenovanju i razrešenju donosi Upravni odbor Društva.

Za svoj rad odgovoran je Upravnom odboru i Izvršnom direktoru.

**Uslovi za zasnivanje radnog odnosa su:**

Pravni fakultet opšteg smera sa najmanje 240 ESPB bodova ili ekvivalent

5 godina radnog iskustva u struci,

Poznavanje rada na računaru, Vord, Ekcel i dr.

On/ona mora biti u stanju da radi pod pritiskom, da ima jaku radnu etiku i visok nivo integriteta,

Visina plaćanja prilagođena na osnovu važećih propisa.

**Uz prijavu za poziciju sekretara potrebno je priložiti sledeća dokumenta:**

- Naš CV (biografija),
- kopiju lične karte,
- Fakultetska diploma – kopija, diploma inostranih univerziteta ovjerava se kod notara MASHT-a:
- Sertifikat koji nije pod istragom i
- Dokaz o radnom iskustvu.

**Da popunite poziciju:**

I. Inženjer i. of Construction.

Odgovori: Glavni izvršni direktor.

Mesto rada: Peć. Položaj (1).

Plata: U skladu sa važećim propisima.

Trajanje imenovanja: na određeno 3 godine sa mogućnošću produženja uz probni rad od 6 meseci.

**Radne obaveze:**

Pored obaveza predviđenih zakonom, Statutom Društva i Kodeksom ponašanja,

Radne obaveze su;

Kompilacija projekata,

Priprema ponuda za procedure nabavki,

Vrši pripremu objekata za navodnjavanje na početku sezone i završavamo pripreme za zimu, kao i stručne poslove za tehnička pitanja,

Sastavlja izveštaj o stanju u objektima, potrebnim izborima i nadzoru nad izvođenjem radova u objektima Preduzeća,

Za obavljanje drugih poslova u skladu sa direktivama EK,

EK je odgovoran za svoj rad.

Uslovi za zasnivanje radnog odnosa:

Građevinski fakultet,

Radno iskustvo od 3 godine u struci,

Poznavanje računarskih programa, Vord, Ekcel itd.

On/ona mora biti u stanju da radi pod pritiskom, ima jaku radnu etiku i visok nivo integriteta,

Odluku o zasnivanju radnog odnosa donosi izvršni direktor Kompanija.

**Funkcija: Menadžer operativne jedinice Vendi Istok (1 pozicija) i Dečane (1 pozicija).**

Plata: U skladu sa važećim propisima.

Trajanje imenovanja: na određeno 3 godine sa mogućnošću produženja uz probni rad od 6 meseci.

**Radne obaveze su:**

- Rukovodi operativnom jedinicom, izrađuje predlog godišnjeg plana rada i stara se o korišćenju i održavanju imovine, nadgleda sprovođenje godišnjeg plana, odgovoran je za radnu disciplinu i ažuriranje u okviru jedinice.

Uslovi za zasnivanje radnog odnosa:

- fakultetsku diplomu ekonomije, poljoprivrede ili prava,

- Radno iskustvo od 3 godine na sličnim radnim mestima.

**Uz prijavu je potrebno priložiti i sledeća dokumenta:**

CV (biografija),

Kopija lične karte, dokaz o radnom iskustvu,

Diploma građevinskog fakulteta o traženoj stručnoj spremi - kopija,

Dokaz da niste pod istragom, ne stariji od šest (6) meseci.

Pozicija: Sakupljač zemlje: Peć 3 Punter & Decan 2 Junik radnik 1 Punter sa 1-godišnjim ugovorom. U Istoku 2 sezonski radnik

**Radne obaveze su:**

- Moraju biti dežurni 24 sata, za zahteve hitne pomoći i odvajanja za usluge koje im kompanija nudi.

Uslovi za zasnivanje radnog odnosa.

- Školska sprema - osnovna - srednja

- Radno iskustvo, imamo slično.

**Aplikacija postupak:**

**Dokumenti se predaju u kancelariju br. 1 KRU "Drini i Bardhe" ulica "Breteresha Teute" br. 85 Peć.**

Uz prijavu je potrebno priložiti i sledeća dokumenta:

CV (biografija),

Kopija lične karte, dokaz o radnom iskustvu,

diploma osnovne ili srednje škole za traženu stručnu spremu – kopija,

Dokaz da niste pod istragom, ne stariji od šest (6) meseci.

**Aplikacija postupak:**

**Popunjene prijave po ovom konkursu šalju se u Kancelariju administrativnog pomoćnika NP. K.R.U "Drini i Bradhe" SH.A na adresi UL " Mbretëresha Teute" br.85 Peć, konkurs je otvoren od 03.11.2024 do 31.03.2024, prijave se mogu predati od 8:00 do 16:00 časova.**

**Predstavljanje zahteva:**

Prijave poslate posle poslednjeg datuma neće biti prihvaćene. Nepotpune prijave će biti odbijene.

U slučaju većeg broja prijavljenih, biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u uži izbor. Kandidati koji budu izabrani i pozvani na intervju moraju poneti originalna dokumenta.





ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

